



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.12.2020 të parashtruar nga **OE "NSH EKO DDD"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore"** me Nr. të Prok: **616-20-3417-221** dhe numër te brendshëm: **616 20 099 221** nxjerr:

### V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e **OE "NSH EKO DDD"** të datën 03.12.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore"**, me Nr. të Prok: **616-20-3417-221** dhe numër te brendshëm **616 20 099 221**.
2. Vertetohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, të publikuar me datë: 03/12/2020.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

**OE "NSH EKO DDD"** me datë 03.12.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Dezinfektimi,dezinsektimi dhe deratizimi i Institucioneve Arsimore "**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 04.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Lidhur me pretendimin se ju keni deshmi për import për produktet e kerkuara ju sqarojme se edhe perkunder deklarimit paraprak te prodhuesit per Autoritetin Kontraktues nuk ka qene e qarte se si produkti i njejte mund te kete dy afate te skadimit e aqe me pak produkti i serise se njejte.Praktika e te gjithe OE-ik ekonomik e edhe e prodhueseve eshte qe per çdo rast te pergatisin dokument te ri,ndersa ne rastin tuaj kemi dokument identik ku ndryshon vetem data e skadimit.Lidhur me leshimin e çdo dokumenti ne çdo rast besoj se e kujtoni nje pretendim


tuajin ne procedurat paraprake per nje tenderues tjeter,e te cilin e kemi pranuar si te bazuar dhe njekohesisht keshtu duhet te pranohet ne çdo rast.Paraqitja e dy dokumenteve pothuajse te njejta,ku ndryshon vetem data e skadimit ka qene e pa qarte dhee pakuptueshme dhe kjo ka qene arsyeja qe kemi hulumtuar produktin e ofruar ne faqen zyrtare te prodhuesit dhe pastaj kemi kerkuar sqarime plotesuese nga I njejti.Sipas sqarimit te dhene rrjedh se me Rregulloren e re afati I perdorimit eshte tri vite,mirepo edhe kjo nuk mund te jete e besueshme,pasi qe ne faqen zyrtare te te njejtit qendron edhe me tutje deklarimi se afati I perdorimit per kete produkt eshte dy vite dhe ate ne paketim origjinal dhe hapesire te thate(pa lageshti).Bazuar ne kete edhe dokumenti(deklarata doganore)qe e keni bashkengjitur si deshmi nuk e arsyeton pretendimin tuaj,pasi qe eshte dokument qe ka date me te vjeter se dy vite(me shume se afati I skadimit)dhe eshte deshmi per importim te produktit pa paketim e qe bie ne kundershtim edhe me kushtet e perdorimit per afatin e dhene ne faqen zyrtare te prodhuesit.

Bazuar ne keto sqarime rrjedh se pretendimet tuaja jane te pa bazuara dhe lidhur me afatet e ndryshme te skadimit te dhena ne nje dokument do te kerkojme trajtim nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.  
Shtojce:Bashkengjitur keni komunikimet me prodhuesin.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit